



## Instituti i trajnimeve

### Seanca informuese mbi detyrimin për ushqim për fëmijët

**Ju mirëpresim në uebinaret tona virtuale pa pagesë mbi detyrimin për ushqim për fëmijët. Çdo seancë nis me një prezantim që vijohet nga një sesion pyetje-përgjigjesh.**

Instituti i Trajnimeve i Zyrës së Shërbimeve të Detyrimit për Ushqim për Fëmijët (OCSS) të HRA-së prezanton një seri të vazhdueshme uebinaresh pa pagesë të krijuara për të hedhur dritë mbi aspektet ndonjëherë të ndërlikuara të detyrimit për ushqim për fëmijët. Uebinare synohen për stafin në agjencitë e qytetit dhe organizatat komunitare, si edhe për prindërit, por edhe për profesionistët që punojnë me këta prindër. Çdo seancë nis me një prezantim që vijohet nga një sesion pyetje-përgjigjesh.

Nëse hasni vështirësi gjatë regjistrimit në seanca, na kontaktoni menjëherë me email në [OCSS.TrainingInstitute@dfa.state.ny.us](mailto:OCSS.TrainingInstitute@dfa.state.ny.us).

#### Prezantimet e ardhshme

E martë, 24  
shtator në orën  
10:00 – 11:00  
paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



#### Hyrja në çështjet e detyrimit për ushqim për fëmijët në shtete të ndryshme

Shumica e çështjeve të detyrimit për ushqim për fëmijët përfshijnë një prind kujdestar dhe një jokujdestar që jetojnë nën të njëjtin juridiksion. Gjithsesi, ka raste ku prindërit jetojnë në dy juridiksione ose shtete të ndryshme dhe programet e detyrimit për ushqim për fëmijët në ato juridiksione duhet të bashkëpunojnë për të ofruar shërbimet e detyrimit për ushqim për fëmijët. Detyrimi për ushqim për fëmijët përbën detyrim federal, mbikëqyret nga shteti dhe në NY administrohet në mënyrë lokale. Edhe pse ka shumë faktorë të ndryshëm për t'u marrë parasysh, ky uebinar do të trajtojë bazat e mënyrave se si agjencitë e ndryshme të detyrimit për ushqim për fëmijët bashkëpunojnë për të ofruar mbështetjen që u nevojitet fëmijëve, pavarësisht se ku jetojnë ata dhe prindërit e tyre. Regjistrohuni në <https://bit.ly/49FCCQ9>.



E martë, 8 tetor  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite



#### Si mund të...? Informacion mbi menaxhimin e një çështjeje të detyrimit për ushqim për fëmijën

Pjesëmarrësit do të mësojnë si të kryejnë disa veprimtari të rëndësishme të lidhura me detyrimin për ushqim për fëmijën, duke përfshirë përgatitjen për gjyq, kryerjen e një pagese, modifikimin e një urdhri për detyrimin për ushqim për fëmijën, lidhjen e një marrëveshjeje për takimet prindërore dhe marrjen e ndihmës për problemet e lidhura me detyrimin për ushqim për fëmijën.

Regjistrohuni në <https://rb.gy/tpbi29>.



Më e përshtatshme për: Prindërit Juristët Agjencitë dhe organizatat në mbështetje të prindërve

Të gjithë uebinarët janë në anglisht dhe spanjisht. Dërgoni email në [ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us](mailto:ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us) për të kërkuar një intepret, të paktën 48 orë para datës së seancës.

## Prezantimet e ardhshme

E martë, 22 tetor  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite



### Snapshot: Një instrument për organizatat komunitare

OCSS ka projektuar instrumentin Snapshot për t'i mundësuar stafit të organizatave komunitare marrjen e detajeve bazë rreth një çështjeje për detyrimin për ushqim për fëmijën. CBO-të dhe grupet e këshillimit janë këshilltarë të besueshëm që ofrojnë një lidhje kyç me shërbimet për klientët e tyre. Snapshot është një instrument i sigurt në internet që i lejon grupet të ndihmojnë klientët duke aksesuar "fotografinë e çastit" (Snapshot) të çështjes së tyre të detyrimit për ushqim për fëmijën. Ky dokument një-faqësh rendit pagesat e kryera, shumën e parave që detyrohen dhe kujt i detyrohen, si edhe çdo veprim përforcues të ndërmarrë në çështje. Përfshin edhe një listë të hapave të radhës të rekomanduara si përgjigje ndaj detajeve të çështjes specifike. Për të ruajtur privatësinë e klientit, nevojitet një formular lejeje i firmosur i OCSS Child Support Snapshot për të publikuar informacionin në organizatën tuaj. Për t'u regjistruar, dërgoni email në adresën [OCSSinfo@dfa.state.ny.us](mailto:OCSSinfo@dfa.state.ny.us) me titull subjekti "Child Support Snapshot". Regjistrohuni në <https://rb.gy/21pzv0>.



E martë, 29 tetor  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite



### Çështjet e detyrimit për ushqim për fëmijën për veteranët dhe ushtarakët aktivë

Pjesëmarrësit do të mësojnë rreth rëndësisë së detyrimit për ushqim për fëmijën për veteranët dhe familjet e tyre, si edhe burimet që janë të disponueshme për veteranët dhe ushtarakët aktivë në lidhje me çështjet e detyrimit për ushqim për fëmijën. Regjistrohuni në <https://bit.ly/47LUEA3>.



E martë, 12  
nëntor në orën  
10:00 – 11:00  
paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Opsionet e marrëveshjeve dhe ndërmjetësimeve për detyrimin për ushqim për fëmijët

Seanca është e hapur për të gjithë prindërit kujdestarë dhe jokujdestarë, të cilët kërkojnë urdhër për detyrimin për ushqim për fëmijët, për të zbuluar se si marrëveshjet, qoftë për një urdhër të ri ose për ndryshime të urdhrit ekzistues, mund të përdoren për të thjeshtuar dhe përshpejtuar procesin e detyrimit për ushqim për fëmijët duke kufizuar vizitat në gjykatën për çështjet familjare. Në këtë seancë do të trajtohet gjithashtu mënyra se si mund të përdoret ndërmjetësimi për të adresuar rastet e detyrimeve të pashlyera për ushqim për fëmijët ndaj prindit kujdestar. Regjistrohuni në <https://rb.gy/reuve8>.



E martë, 19  
nëntor në orën  
10:00 – 11:00  
paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Si të përgatiteni për gjyq, çfarë të sillni dhe çfarë mund të prisni

Pjesëmarrësit do të mësojnë rreth rolit të Gjykatës për Çështjet Familjare në përcaktimin dhe modifikimin e urdhrave të detyrimit për ushqim për fëmijën dhe si të përgatiten për gjyq. Prindërit mund të paraqiten pa avokat. Më e mira është të jeni të përgatitur dhe të sillni dokumentet e duhura. Kjo seancë do të përshkruajë çfarë ndodh gjatë një seance dëgjimore për detyrimin për ushqim për fëmijën, çfarë dokumentesh nevojiten dhe çfarë do të thotë rezultati për të dy prindërit, si për atë kujdestar ashtu edhe për atë jokujdestar. Regjistrohuni në <https://rb.gy/z3jj87>.



Më e përshtatshme për:  Prindërit  Juristët  Agjencitë dhe organizatat në mbështetje të prindërve

Të gjithë uebinarët janë në anglisht dhe spanjisht. Dërgoni email në [ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us](mailto:ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us) për të kërkuar një intepret, të paktën 48 orë para datës së seancës.

## Prezantimet e ardhshme

E martë, 3  
dhjetor në orën  
10:00 – 11:00  
paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Seancë e veçantë ekzekutive: Pyetje dhe përgjigje me drejtuesit e OCSS-së

Eventi është i hapur për të gjithë anëtarët e komunitetit, duke përfshirë prindërit kujdestarë dhe jokujdestarë, me ose pa urdhër detyrimi për ushqim për fëmijët. Drejtuesit e OCSS-së dëshirojnë të kontaktojnë me ju dhe t'ju dëgjojnë. Ata do të bëjnë prezantime të shkurtra lidhur me mënyrën se si funksionon detyrimi për ushqim për fëmijët në NYC dhe do t'u përgjigjen pyetjeve nga pjesëmarrësit për çdo gjë që ka të bëjë me detyrimin për ushqim për fëmijët. **Regjistrohuni në <https://rb.gy/a1y8ab>.**



E martë, 17  
dhjetor në orën  
10:00 – 11:00  
paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Nisja e procesit të detyrimit për ushqim për fëmijët: Çfarë mund të pres?

Detyrimi për ushqim për fëmijët është një çështje e ndërlikuar dhe shumë individë që mund të jenë duke e konsideruar këtë opsion ose që zbulojnë se janë thirrur në një seancë dëgjimore lidhur me detyrimin për ushqim për fëmijët, nuk dinë çfarë të presin. Studimet kërkimore tregojnë se shumë prindër të vetëm, sidomos ata me të ardhura të ulëta, janë të kualifikueshëm për të përfituar detyrim për ushqim për fëmijët, por nuk kanë aplikuar. Ky uebinar shqyrton të gjithë hapat fillestarë të procesit, që nga hapja e një çështjeje për detyrim për ushqim për fëmijët deri te pjesëmarrja në seancë dëgjimore përballë Magjistratit për Çështjet Familjare në gjykatën për çështjet familjare. Do të trajtojmë të gjithë hapat dhe dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet, si edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në seancën dëgjimore. Do të diskutohet gjithashtu edhe për afatet kohore të përgjithshme për lëshimin e një urdhri për detyrim për ushqim për fëmijët. Do të shqyrtojmë edhe paketën tonë të re të materialeve që u jepet prindërve/kujdestarëve që po aplikojnë për shërbime të detyrimit për ushqim për fëmijën dhe atyre të cilëve u është përcaktuar data e seancës dëgjimore. **Regjistrohuni në <https://rb.gy/wf9nmu>.**



E martë, 7 janar  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Bazat e detyrimit për ushqim për fëmijët

Ky uebinar ofron një përmbledhje të procesit të detyrimit për ushqim për fëmijët, duke përfshirë informacione mbi vlerën e detyrimit për ushqim për fëmijët, ciklin kohor të çështjeve të detyrimit për ushqim për fëmijët dhe një përshkrim të programeve të krijuara në përfitim të prindërve që kanë çështje të hapura të detyrimit për ushqim për fëmijët. **Regjistrohuni në <https://rb.gy/3958c1>.**



Më e përshtatshme për: Prindërit Juristët Agjencitë dhe organizatat në mbështetje të prindërve

Të gjithë uebinarët janë në anglisht dhe spanjisht. Dërgoni email në [ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us](mailto:ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us) për të kërkuar një intepret, të paktën 48 orë para datës së seancës.

## Prezantimet e ardhshme

E martë, 14 janar  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Veprimet përforcuese administrative të detyrimit për ushqim për fëmijët: Çfarë duhet të dini

Ky trajnim thellohet në veprimet përforcuese administrative që ndërmerren kur pagesat e detyrimit për ushqim për fëmijët nuk kryhen në kohën e duhur dhe kur akumulohen shuma të prapambetura. Pjesëmarrësit do të informohen mbi rastet kur ndërmerren veprime përforcuese administrative, mbi përjashtimet dhe mënyrën e kundërshtimit të një veprimi përforcues administrativ. **Regjistrohuni** në <https://rb.gy/azx8uw>.



E martë, 28 janar  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Detyrimi për ushqim për fëmijët: Opsionet e reduktimit të detyrimit të pashlyer për PJK-të

Detyrimet e pashlyera për ushqim për fëmijët përbëjnë një problem serioz për prindërit jokujdestarë, si edhe për prindërit kujdestarë dhe fëmijët e tyre. Ato çojnë drejt veprimeve përforcuese që mund të kenë implikime në ruajtjen e vendit të punës, të krijojnë barriera për angazhimin e babait dhe të shkaktojnë stres për të gjitha palët. Në fakt, ata që kanë për të shlyer detyrime janë përgjithësisht PJK-të me mundësi të pakta pagese. HHS-ja ka rekomanduar që shuma e detyrimit të pashlyer të reduktohet për të ndihmuar në shmangien e incidenteve të abuzimit dhe neglizhencës së fëmijëve. Pjesëmarrësit do të mësojnë mbi programet e rëndësishme të OCSS-së që mund të reduktojnë në rrugë administrative detyrimin e pashlyer ndaj shtetit për ushqim për fëmijët, mbi strategjitë për të shmangur krijimin e detyrimeve të pashlyera, si edhe mbi një opsion për të negociuar detyrimet e pashlyera ndaj prindërve kujdestarë. **Regjistrohuni** në <https://rb.gy/s4i59o>.



E martë, 4 shkurt  
në orën 10:00 –  
11:00 paradite

Më e  
përshtatshme  
për:



### Bazat e detyrimit për ushqim për fëmijën për prindërit e rinj

Kjo seancë është e hapur për të gjithë prindërit, prindërit jokujdestarë dhe kujdestarë me një urdhër të detyrimit për ushqim për fëmijën, si dhe për prindërit që po mendojnë të aplikojnë për detyrimin për ushqim për fëmijën. Pjesëmarrësit do të mësojnë rreth bazave të detyrimit për ushqim për fëmijën: kualifikueshmëria, procesi i aplikimit, marrja e sigurt e detyrimit për ushqim për fëmijën dhe çfarë mund të pritët gjatë kohëzgjatjes së çështjes së detyrimit për ushqim për fëmijën. **Regjistrohuni** në <https://rb.gy/80vx5x>.



Më e përshtatshme për:  Prindërit  Juristët  Agjencitë dhe organizatat në mbështetje të prindërve

Të gjithë uebinarët janë në anglisht dhe spanjisht. Dërgoni email në [ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us](mailto:ocss.traininginstitute@dfa.state.ny.us) për të kërkuar një intepret, të paktën 48 orë para datës së seancës.